



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°3/2022

Hagë, 27/01/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Ditën e premte, më 21 janar, Trupi Gjykses I urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa. Gjykatësit konstatuan se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit gjyqësor, ku përfshihet dhe rreziku i ndërhyrjes ndaj viktimave, dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre.

Më 25 janar 2022, dëshmitari i parafundit i thirrur nga Prokuroria dëshmoi në *çështjen Salih Mustafa* lidhur me hierarkinë e komandimit, format e komunikimit dhe lëvizjet e UÇK-së në rajonin e Gollakut. Gjithashtu, dëshmitari dëshmoi lidhur me njësitin BIA dhe rolin dhe funksionin e UÇK-së në muajin prill 1999. Më tej ai dha prova lidhur me ofensivën e forcave serbe në zonën e Zllashit në gjysmën e dytë të muajit prill 1999. Dëshmitari dëshmoi pa masa mbrojtëse.

Javën e ardhshme, më 1 shkurt 2022, është parashikuar të fillojë dëshminë dëshmitari i fundit i thirrur në këtë çështje. Më 4 shkurt pritet që Prokuroria të mbyllë paraqitjen e provave të veta.

Më 11 shkurt, Mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave do të dorëzojnë listat e veta përkatëse të dëshmitarëve dhe provave materiale, ndërsa më 17 e 18 shkurt 2022, Trupi Gjykses I do të mbajë konferencën për ecurinë e çështjes në prani të Prokurorisë, Mbrojtjes, mbrojtëses së viktimave dhe Zyrës Administrative për të diskutuar etapat e ardhshme të çështjes. Më pas, Trupi Gjykses do të vendosë mbi numrin dhe modalitetet e dëshmitarëve që do të japin dëshmi si dhe oraret e seancave.





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°3/2022

Hagë, 27/01/2022

Në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, dëshmitarja e tretë e thirrur prej Mbrojtjes së Haradinajt dëshmoi të premtën, më 21 janar. Dëshmitarja dha dëshmi lidhur me fushëveprimin e përkufizimit si dhe jurisprudencën lidhur me sinjalizuesit.

Dëshmitari i katërt i thirrur prej Mbrojtjes së Haradinajt filloi me dëshminë e tij ditën e hënë, më 24 janar, me anë të videolidhjes. Dëshmitari dëshmoi lidhur me operacionet e kërkimit dhe sekuestrimit në TPNJ. Ai do të vazhdojë dëshminë e tij të premtën, më 28 janar në orën 8:00 të mëngjesit.

Pas kësaj dëshmie, Trupi Gjykes do të dëgjojë parashtrimet e Mbrojtjes dhe Prokurorisë për hapat e ardhshëm që duhen ndërmarrë në këtë çështje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të martën, më 25 janar, e dorëzoi versionin e redaktuar publik të vendimit me të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se rreziku që i akuzuari të pengojë procesin gjyqësor apo të kryejë krime të tjera mund të zvogëlohet mjaftueshëm vetëm nëpërmjet rregullave për monitorimin e komunikimeve që zbatohen në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Seanca e ardhshme e procedurës paraprake për këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të premtën, më 4 shkurt, në orën 2:30 të pasdites.

**Pyetje nga gazetarët  
Nuk pati pyetje**

